



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve
www.uamd.edu.al

Durrës, më 12 / 06 / 2016

V E N D I M N r . 1 3

Në mbështetje të ligjit, Nr. 80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, në Republikën e Shqipërisë" e miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me Nr. Prot. 2459/1 dt. 15/03/2016, të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.110, datë 15/03/2016, "Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

vendosi:

- I. Për realizimin e procesit të votimit do të hapen 5 (pesë) Qendra Votimi, respektivisht:
 - a. Për Fakultetin e Biznesit: Qendra e Votimit Nr. 1, godina e Kampusit Universitar (Spitallë), Salla 105, Kati i Dytë.
 - b. Për Fakultetin e Edukimit: Qendra e Votimit Nr. 2, godina e Kampusit Universitar (Spitallë), Salla 017, Kati i Parë.
 - c. Për Fakultetin e Studimeve Profesionale: Qendra e Votimit Nr. 3, godina Qëndrore e UAMD (Currila), Salla 103, Kati i Parë.
 - d. Për Fakultetin e Shkencave Politike Juridike: Qendra e Votimit Nr. 4, godina Qëndrore e UAMD (Currila), Salla 303, Kati i Tretë.
 - e. Për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit dhe Për Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktien: Qendra e Votimit Nr. 5, godina Qëndrore e UAMD (Currila), Salla 203, Kati i Dytë.

KRYETARI KIZ

Drakuli LUMI

SEKRETARE KIZ

Alma BELA

